



Nr. 805, Prot.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Tiranë, më 7.5.2018

URDHËR

Nr. 142, Datë 7.5 /2018

“PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES SË FUNKSIONIMIT
TË FONDIT TË INOVACIONIT

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 8 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 211, date 20.04.2018 “Për krijimin e fondit të inovacionit”

URDHËROJ:

1. Miratimin e Rregullores së Funkcionimit të Fondit të Inovacionit, sipas dokumentit që i bashkëlidhet këtij urdhri.
2. Ngarkohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

ARBEN AHMETAJ





Albanian Investment Development Agency
Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

RREGULLORE E FUNKSIONIMIT TË FONDIT TË INOVACIONIT



Albanian Investment Development Agency
Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PËRMBAJTJA

1. Hyrje.....	2
2. Informacion i Përgjithshëm.....	2
2.1. Kriteret e Aplikimit.....	2
2.2. Financimi Maksimal.....	4
2.3. Kosto që mund të mbulohen nga skema.....	4
2.4. Kostot që nuk mbulohen nga Fondi.....	4
2.5. Përgjegjësitë e përfituesve.....	5
3. Aplikimi.....	6
4. Monitorimi.....	7
4.1. Raportet mbi Projektin e Ndërmarrjes.....	7
5. Procedura e Pagesës.....	7
6. Konfidencialiteti i të dhënave.....	8
7. Menaxhimi i Skemës së Grantit për Ndarjen e Kostove.....	8



Albanian Investment Development Agency
Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

1. Hyrje

Kjo Rregullore përfshin të gjitha procedurat dhe dokumentacionin e detajuar të nevojshëm për të zbatuar në mënyrë profesionale dhe transparente VKM Nr. 211, date 20.04.2018 “Për krijimin e fondit të inovacionit”.

Fondi i inovacionit synon fuqizimin e ndërmarrjeve vendase, për përmirësimin e teknologjisë dhe nxitjen e inovacionit.

2. Informacion i Përgjithshëm

Kjo rregullore është hartuar për t’i shërbyer Ndërmarrjeve Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM). Rregullorja bazohet në parimin e skemës së grantit për ndarjen e kostove. Kjo nënkupton se granti nuk financon gjithë kostot, por vetëm një pjesë të tyre, ndërkohë që pjesa tjetër financon nga përfituesi i grantit (në këtë rast, ndërmarrja shqiptare).

Fondi i inovacionit synon fuqizimin e ndërmarrjeve vendase, për përmirësimin e teknologjisë dhe nxitjen e inovacionit. Fondi i Inovacionit mund të ketë si burim financimi dhe të ardhura nga donatorë apo institucione ndërkombëtare. Në këtë rast rregullat për përfitimin nga fondi do të vendosen në marrëveshje midis AIDA-s dhe donatorëve apo institucioneve ndërkombëtare.

2.1 Kriteret e Aplikimit

Kriteret e posaçme për përfitimin e grantit si dhe dokumentet përkatëse jepen në tabelën më poshtë:

Kriteri	Mbi çfarë faktorësh dhe/ose specifikash aplikohet kriteri	Llojet e dokumenteve provuese lidhur me kriterin
Përshtatshmëria e biznesit me skemën e grantit	<ul style="list-style-type: none">• Biznes i klasifikuar si mikro, i vogël, apo i mesëm sipas ligjit Nr. 8957, datë 17.10.2002, “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”, të ndryshuar.• Ka selinë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.	<ul style="list-style-type: none">• Akti i regjistrimit të ndërmarrjes sipas legjislacionit në fuqi. (Ekstrakti i QKB gjenerohet nga website)• Pasqyrat financiare të vitit të fundit të ndërmarrjes. Në rastet kur bilanci është negativ, ndërmarrja duhet të dorëzojë një vërtetim bankar që vërteton që ndërmarrja ka në llogari bankare një shumë të barabartë me buxhetin e projektit;• Një dokument që vërteton se:<ul style="list-style-type: none">a) ka plotësuar detyrimet fiskale,b) ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AIDA

Albanian Investment Development Agency
Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve

		shoqërore, të lëshuar nga administrata tatimore.
		<ul style="list-style-type: none"> • buxheti i projektit.
Përshtatshmëria e projektit me skemën e grantit	<ul style="list-style-type: none"> • Prodhon në Shqipëri produkte dhe/apo shërbime, të cilat tregtohen brenda dhe/apo jashtë vendit. • Kanë një projekt në përputhje me përcaktimet e VKM-së Nr. 211 datë 20.04.2018 	<ul style="list-style-type: none"> • Projekti i propozuar • Evidenca për produktet e prodhuara ose që do të prodhohen; • Evidenca për shërbimet e ofruara ose që do të ofrohen.
Dokumentet shoqëruese		<ul style="list-style-type: none"> • Dokument identifikimi, i njohur nga ligji, personit që paraqet kërkesën në emër të ndërmarrjesë; • Autorizim që vërteton se personi i cili paraqet kërkesën në emër të ndërmarrjesë, kur ky nuk është titullari i ndërmarrjes, është i autorizuar prej këtij subjekti për të aplikuar dhe për të bërë deklaratimet e kërkuara në emër të ndërmarrjes.

2.2 Financimi Maksimal

Fondi do të rimbursojë kostot e miratuara në përputhje me udhëzimet e mëposhtme:

- Një ndërmarrje mund të përfitojë maksimalisht 400,000 Lekë për një projekt. Për ndërmarrjet që do të aplikojnë për “blerje pajisjesh teknologjike” financimi do të jetë jo më shumë se 600.000 (gjashtëqind mijë) lekë.
- Skema mbulon 50% të kostove të pranuar brenda limitit të mësipërm. Përfitimi i ndërmarrjeve nga mbështetja e programeve apo projekteve për mbulimin e 50% të shpenzimeve të tjera të projektit, që nuk mbulohen nga Fondi i Inovacionit, duke përdorur fonde nga donatorët apo institucione financiare ndërkombëtare, nuk përbën pengesë për përfitim edhe nga Fondi i Inovacionit për të njëjtin projekt.
- Paguesa e fondit të përfituar bëhet 50% në fillim të projektit dhe 50% në përfundim të projektit, kundrejt faturës/faturave e cila/të cilat vërteton/vërtetojnë shpenzimet e kryera të cilat do të dorëzohen në përfundim të projektit;
- Në një vit mund të asistohet 1 projekt për çdo ndërmarrje;
- Pranimi i aplikimeve është subjekt i disponueshmërisë së fondit dhe mund të pezullohet në çdo kohë, në rast se fondi ka mbaruar.
- AIDA në faqen e saj të internetit do të publikojë gjendjen e disponueshmërisë së Fondit të Inovacionit.

